

VENDIM
Nr. 5, datë 26.1.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 18.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (Z) 2025 të Regjistrit Themeltar që u përket:

KËRKUES: Zoica Lina, Ilirjan Lina, përfaqësuar nga avokati Kostandin Trandafili, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Shoqëria e Sigurimeve “Intersig Vienna Insurance Group” sh.a., përfaqësuar nga avokatja Dorina Mustafaraj, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 6791, datë 11.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 730, datë 4.4.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024- 3871 (394), datë 26.6.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1 shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit 12 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësve Zoica dhe Ilirjan Lina (*kërkuesit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, shoqërisë së sigurimeve “Intersig Vienna Insurance Group” sh.a. (*shoqëria e sigurimeve*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë familjarët e trashëgimlënësit Kristaq Lina, që ka qenë bashkëshorti i kërkuësës dhe i ati i kërkuësit, ndërsa Julian Lina ka qenë respektivisht djali i kërkuësës dhe vëllai i kërkuësit. Në datën 9.4.2007 ata kanë qenë duke udhëtuar me biçikletë në aksin rrugor Seman-Fier, kur janë goditur nga një automjet i drejtuar nga shtetasi A.K. Si pasojë e këtij aksidenti, një muaj më pas, në datën 8.5.2007, Kristaq Lina ka humbur jetën. Ndërsa Julian Lina fillimisht ka pësuar dëmtime të rënda të klasifikuara si plagosje e rëndë, duke humbur plotësisht aftësinë për punë dhe më pas, në datën 10.3.2011, ai ka kryer vetëvrasje.

2. Në vijim të aksidentit të ndodhur është zhvilluar një proces gjyqësor penal ndaj shtetasit A.K. (drejtuesi i automjetit), duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal (KP). Gjatë procesit gjyqësor penal, nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është caktuar edhe një ekspert mjeko-ligjor, që ka arritur në përfundimin se shkak i vdekjes së shtetasit Kristaq Lina ka qenë përplasja me makinë. Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor për shtetasin Julian Lina janë evidentuar politrauma me gjendje shoku traumatik, tronditje e rëndë e trurit e shoqëruar me koma cerebrale traumatike dhe dëmtime të tjera, që të gjitha së bashku kanë qenë të rrezikshme për jetën. Për shtetasin A.K., me vendim përfundimtar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është vendosur deklarimi fajtor për kryerjen e veprës penale shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, duke u dënuar përfundimisht, në aplikim të gjyqimit të shkurtuar, me 3 vjet e 4 muaj burgim. Në bazë të nenit 59 të KP-së është vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit, duke u vënë në shërbim prove për një afat prej 3 vjetësh.

3. Automjeti i drejtuar nga shtetasi A.K., që ka shkaktuar aksidentin, ka qenë i siguruar pranë shoqërisë së sigurimit/subjekti i interesuar me policën e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësi ndaj palëve të treta me afat nga 22.4.2006 deri në 21.4.2007. Duke qenë se aksidenti ka ndodhur në datën 9.4.2007, dëmi i ardhur si pasojë e tij do të mbulohej nga polica e sigurimit.

4. Për kërkimin e shpërblimit të dëmit të shkaktuar si pasojë e aksidentit, kërkuessit në datën 2.4.2009 i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar/shoqërisë së sigurimit për të paguar në favor të tyre dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe shpenzimet e tjera të arsyeshme e të nevojshme në shumën totale 24.516.263 lekë, kamatëvonesat për shkak të dëmit të shkaktuar nga aksidenti, që sipas tyre ishte në shumën 7.595.286 lekë, si dhe interesat ditore mbi këtë shumë deri në ekzekutim. Eksperti i caktuar nga gjykata e shkallës së parë për nxjerrjen e vlerës financiare për dëmin pasuror dhe jopasuror i është referuar dekretit nr. 295, datë 15.9.1992, “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” (*dekreti nr. 295/1992*), rregullores nr. 622/1, datë 15.12.1992, “Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” (*rregullorja nr. 622/1, datë 15.12.1992*) dhe vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 12/2007*). Gjykata e shkallës së parë në përcaktimin e vlerës së dëmshpërblimit i është referuar vlerës së pensionit mesatar në vend. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 487, datë 27.1.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe detyrimin e shoqërisë së sigurimit të dëmshpërblejë kërkuessit/paditësit për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga vdekja e shtetasit Kristaq Lina në shumën 6.124.757 (gjashtë milionë e njëqind e njëzet e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë. Detyrimin e palës së paditur/shoqërisë së sigurimit që të dëmshpërblejë kërkuessit për dëmin pasuror dhe jopasuror të Julian Linës në shumën 4.244.291 (katër milionë e dyqind e dyzet e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë. Ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për kamatëvonesat, pasi kërkuessit i janë drejtuar drejtpërdrejt gjykatës pa shteruar rrugën jashtëgjyqësore.

5. Pas ankimit të të dyja palëve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2960, datë 18.12.2012, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 487, datë 27.1.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se gjatë gjyqimit në shkallë të parë nuk janë marrë prova thelbësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si dhe akti i ekspertimit mbi të cilin gjykata ka mbështetur vendimin është në kundërshtim me dispozitat procedurale, sepse pavarësisht se Julian Lina ka

ndërruar jetë gjatë gjykimit të zhvilluar në shkallën e parë (në datën 10.3.2011), ajo e ka thirrur si palë në proces.

6. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë kalimin procedural për Julian Linën, sipas nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duke vijuar gjykimin me nënën e tij/kërkuesen Zoica Lina. Referuar nenit 185 të KPC-së, kërkuesit në datën 1.4.2014 kanë shtuar objektin e padisë, duke i shtrirë kërkimet edhe për Julian Linën dhe duke kërkuar dëm pasuror e jopasuror për shkak të vdekjes së tij, pasi fillimisht ishte kërkuar vetëm shpërblimi për paaftësinë e plotë. Në këto kushte, kërkuesit kanë kërkuar dëmshpërblimin nga shoqëria e sigurimeve, në referim të nenit 13 të dekretit nr. 295/1992, sipas së cilit personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë drejtpërdrejt nga shoqëria siguruese, brenda kufijve të përgjegjësisë së tij sipas kontratës së sigurimit, shpërblimin e dëmit. Gjithashtu, kërkuesit kanë kërkuar edhe kamatëvonesat.

7. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6791, datë 11.6.2014 (*vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*) ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe detyrimin e shoqërisë së sigurimit të dëmshpërblejë kërkuesit për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar si pasojë e vdekjes së shtetasve Kristaq Lina e Julian Lina në shumën totale 20.207.083 lekë (njëzet milionë e dyqind e shtatë mijë e tetëdhjetë e tre), e cila është ndarë si vijon: i. kërkuesit janë dëmshpërblyer bashkërisht me shumën 2.269.270 (dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë si dëm pasuror të pësuar nga vdekja e Kristaq Linës; ii. kërkuesja Zoica Lina është dëmshpërblyer në shumën 3.126.957 lekë (tre milionë e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) si dëm jopasuror (moral dhe ekzistencial) të pësuar nga vdekja e bashkëshortit; iii. kërkuesi Ilirjan Lina është dëmshpërblyer në shumën 1.563.478 lekë (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) si dëm jopasuror (moral dhe ekzistencial) të pësuar nga vdekja e të atit; iv. Zoica Lina dhe Ilirjan Lina janë dëmshpërblyer bashkërisht në shumën 2.772.897 lekë (dy milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) si dëm pasuror dhe jopasuror (moral dhe ekzistencial), të pësuar për shkak të paaftësisë së plotë të Julian Linës; v. kërkuesit janë dëmshpërblyer bashkërisht me shumën 3.171.280 lekë (tre milionë e njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë) si dëm pasuror të pësuar nga vdekja e Julian Linës; vi. kërkuesja Zoica Lina është dëmshpërblyer në shumën 4.868.801 lekë (katër milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e një) si dëm jopasuror (moral dhe ekzistencial) të pësuar nga vdekja e Julian Linës; vii. kërkuesi Ilirjan Lina është dëmshpërblyer në shumën 2.434.400 lekë (dy milionë e katërqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind) si dëm jopasuror (moral dhe ekzistencial) të pësuar nga vdekja e të vëllait. Për kërkimin e kamatëvonesave, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin, pasi kërkuesit nuk kishin shteruar rrugën administrative, por edhe proceduralisht ky kërkim nuk ka ndodhur që në fillim të gjykimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arsyetuar se në rastin konkret zbatohet dekreti nr. 295/1992, si dhe dispozitat (nenet 608, 609, 625, 641 dhe 643) e Kodit Civil (KC-së), pasi rasti ka ndodhur në datën 9.4.2007. Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” (ligji nr. 10076/2009) ka dalë më vonë dhe nuk ka fuqi prapavepruese.

8. Pas ankimit të kërkuesve dhe shoqërisë së sigurimit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 730, datë 4.4.2016 (*vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë*) ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke detyruar shoqërinë e sigurimit të dëmshpërblejë kërkuesit për dëmin pasuror dhe jopasuror në shumën totale 12.115.957 lekë (dymbëdhjetë milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) dhe rrëzimin e kërkimit për kamatëvonesat. Gjatë gjykimit, gjykata e apelit, në kushtet kur pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur kanë të bëjnë me faktorë determinues

për përllogaritjen e dëmit pasuror dhe jopasuror, ka vendosur përsëritjen pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor dhe thirrjen e ekspertit për të dhënë shpjegime rreth aktit të ekspertimit të kryer në shkallë të parë dhe si pasojë kryerjen e shtesës së aktit të ekspertimit. Në llogaritjen e dëmit pasuror dhe jopasuror, eksperti është bazuar në dispozitat e KC-së, nenin 27 të rregullores nr. 622/1, datë 15.12.1992, si dhe vendimin unifikues nr. 12/2007.

9. Në datën 21.4.2016 kërkesit kanë ushtruar rekurs dhe në datën 13.5.2016 shoqëria e sigurimit ka paraqitur kundërrekurs. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-3871 (394), datë 26.6.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë për kërkimin në lidhje me kamatëvonesat për shumën e dëmshpërblimit, duke detyruar shoqërinë e sigurimit të paguajë interesat për vlerën totale të dëmshpërblimit të caktuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, sipas normës së interesit bazë të depozitës sipas Bankës së Shqipërisë, duke filluar llogaritja nga data 1.4.2014 deri në momentin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë për pjesën tjetër të kërkimeve. Gjykata e Lartë ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e Gjykatës së Apelit për ligjin e zbatueshëm, që, në rastin konkret, nisur nga koha e ndodhjes së aksidentit me pasojë vdekjen, janë dekreti nr. 295/1992 me ndryshimet përkatëse, rregullorja nr. 622/1, datë 15.12.1992, si dhe vendimi unifikues nr. 12/2007 (*shih paragrafin 41 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka gjetur të pabazuar në ligj qëndrimin e gjykatave më të ulëta për pagesën e kamatëvonesave, duke arsyetuar se llogaritja e kamatëvonesave në rastin konkret do të fillojë nga momenti i kërimit të tyre, data 1.4.2014, deri në momentin e ekzekutimit të vendimit nr. 730, datë 4.4.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka përcaktuar vlerën përkatëse të dëmshpërblimit. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se e drejta për të kërkuar kamatëvonesat është në vetvete një e drejtë me natyrë ligjore e nuk është e kushtëzuar me momentin kohor të ngritjes së padisë, dhe vetë i padituri ose përmbartuesi gjyqësor në momentin e ekzekutimit duhet të llogarisë kamatëvonesat në bazë të përqindjes së normës bazë të interesit të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

10. Kërkesit në datën 17.2.2025 i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, gjatë shqyrtimit paraprak në datën 13.5.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën 19.11.2025 një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se kishte qenë në përbërjen e trupit gjykues që ka dhënë vendimin nr. 2960, datë 18.12.2012, me të cilin, mbi ankimin e të dyja palëve ndërgjyqëse, vendimi i gjykatës së shkallës së parë që kishte vendosur për themelin e çështjes është prishur dhe çështja është dërguar për rigjykim, ndërsa në vijim janë dhënë vendimet gjyqësore të kundërshtuara. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 19.11.2025, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vlerësuar se gjyqtari gjendej përpara rastit të parashikuar në nenin 36, pika 1, shkronja ç”, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 18, pika 1, shkronja “ç”, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se gjatë procesit gjyqësor është cenuar:

11.1. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, i garantuar në nenin 18 të Kushtetutës*, pasi gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë i kanë mohuar trashëgimlënësit Julian Lina, për rrjedhojë edhe trashëgimtarëve të tij, vlerën e dëmit pasuror dhe biologjik për paafësi

të përhershme në punë nga dita e aksidentit deri ditën kur ai ka ndërruar jetë. Të miturit Julian Lina i është mohuar llogaritja e dëmit pasuror për paaftësi të plotë të përhershme nga viti 2007 deri në datën 10.3.2011 kur ka ndërruar jetë. Për më tepër, sipas rregullores nr. 53, datë 25.6.2009, "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit" (*rregullorja nr. 53/2009*), parashikohet se dëmi biologjik duhet të llogaritet sikur ai të kishte jetuar. Eksperti gjatë gjykimit në shkallë të parë duke u bazuar në aktet në fuqi në momentin e aksidentit ka llogaritur dëmin pasuror dhe atë biologjik për paaftësi të plotë në punë 100% për periudhën 2007-2011, në një vlerë të caktuar. Gjykata e apelit ka riçelur hetimin gjyqësor dhe pa e kërkuar palët ka caktuar po të njëjtin ekspert. Gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se shtetasi Julian Lina nuk duhet të përfitonte shpërblimin e dëmit si pasojë e paaftësisë së plotë të përhershme për periudhën 2007-2011. Ajo e ka trajtuar ndryshe rastin për Julian Linën krahasuar me raste analoge për përcaktimin e dëmshpërblimit, duke i hequr mundësinë për të përfituar vlerën e dëmit pasuror dhe biologjik për periudhën kohore 2007-2011. Gjykata e apelit ka shkuar më tej kur ka arsyetuar se të ardhurat duhet të llogariten duke u bazuar në trefishin e pensionit minimal në fshat, duke paragjykuar të ndjerin Julian Lina që kishte moshën 16 vjeç në momentin e shkakimit të dëmit, si anëtar të kooperativës bujqësore, kur në fakti duhet t'i referohej nenit 646 të KC-së dhe pagës minimale në shkallë vendi në kohën kur ka ndodhur aksidenti. Gjykatat kanë diskriminuar edhe kërkuuesin Ilirjan Lina për vlerën e shpërblimit të dëmit jopasuror, me arsyetimin se dhimbja nuk është e njëjtë me atë të nënës. Trashëgimlënësit Julian Lina nuk i është njohur e drejta e përfitimit të dëmit pasuror për paaftësi të plotë dhe është diskriminuar në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 12/2007 dhe nenin 18 të Kushtetutës.

11.2. *Parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka realizuar funksionin e saj rishikues dhe kontrollues ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta në përputhje me ligjin, duke ligjëruar shkeljet e tyre. Kërkuuesit kanë ushtruar rekurs në datën 21.4.2016 dhe sipas nenit 472 të KPC-së në fuqi në atë kohë palët ushtrojnë rekurs për çdo shkelje të ligjit. Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve për shkak të rëndësisë së saj. Gjykata e Lartë nuk ka vepruar sipas ligjit të kohës dhe ka kufizuar të drejtën e aksesit, duke mos u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs për shkeljet e kryera nga gjykata e apelit në drejtim të *parimit të kontradiktoritetit, disponibilitetit, së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të paanshmërisë*, pasi kërkuuesit nuk kanë pasur mundësi për të debatuar rreth caktimit të detyrave të ekspertit dhe ata kanë kërkuar përjashtimin e trupit gjykues dhe të ekspertit.

11.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, sepse nuk ka arsyetuar për pretendimet e ngritura në rekurs që lidheshin me zbatimin e ligjit në kohën kur ka ndodhur aksidenti dhe qëndrimin e saj që ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së apelit. Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka dhënë konkluzione kategorike, pa argumente ligjore, duke keqinterpretuar ligjin dhe faktet.

11.4. *E drejta e pronës, pritshmëritë e ligjshme dhe parimi i sigurisë juridike*, pasi në konceptin e pronës përfshihen të drejta dhe interesa të tjerë që përbëjnë asete, pra pasuri. Kërkuuesit kanë pasur pritshmëri të ligjshme për dëmin pasuror, duke u bazuar në dekretin nr. 295/1992 dhe praktikën gjyqësore për rastet e sigurimit, gjë që përbën pritshmëri të ligjshme për një interes pasuror të ardhshëm. Për dëmin jopasuror kërkuuesit kanë pasur pritshmëri të ligjshme, duke u bazuar në vendimin unifikues nr. 12/2007, që plotësoi boshllëkun ligjor duke vendosur se trashëgimtarët e personave që kanë humbur jetën në aksident kanë të drejtë të përfitojnë dëm jopasuror. Gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë kanë mbajtur qëndrime kontradiktore për vlerën e dëmshpërblimit që u takon kërkuësve, pasi ato gjykata kanë

interpretuar në mënyrë të gabuar dekretin nr. 295/1992, KC-në, udhëzimin e ministrit të Financave dhe ligjin nr. 10076/2009.

12. **Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimeve**, ka paraqitur prapësime me shkrim si vijon:

12.1. *Pretendimet për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit dhe parimit të gjyimit nga një gjykatë e caktuar me ligj* janë të pabazuara, pasi Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në rastin konkret gjen zbatim dekreti nr. 295/1992, me ndryshimet përkatëse të bëra nga rregullorja nr. 622/1, datë 15.12.1992, duke mos u cenuar as parimi i barazisë përpara ligjit. Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim duke argumentuar çdo pretendim të kërkuësve. Pretendimet e paraqitura nga kërkuësit lidhen me aspekte të hetimit gjyqësor dhe vlerësimin e provave shkencore me ekspert. Edhe gjykata e apelit ka vepruar duke respektuar dispozitat procedurale për hetimin gjyqësor.

12.2. *Pretendimi për cenimin e parimit të gjyimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe sigurisë juridike* është tërësisht i pambështetur në ligj, pasi nuk ka pasur asnjë moment që gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë të kenë pasur paqartësi ose problematikë që lidhet me gjykimin ose kompetencat e tyre. Argumenti i kërkuësve se ky parim është cenuar vetëm për faktin se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit nuk përbën shkelje kushtetuese.

12.3. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës dhe pritshmërive të ligjshme* nuk është i bazuar. Kërkuësit gabojnë kur pretendojnë se duhet të përfitonin dëmshpërblim pasuror gjatë kohës së paaftësisë të të ndjerit Julian Lina, për shkak të pakësimit të të ardhurave të personit të paaftë për punë. Në rastet kur i dëmtuari është i mitur duhet që humbja ose pakësimi i aftësisë për punë të ketë qenë e përhershme që të llogaritet dëmi pasuror, ndërsa në rastin konkret humbja e aftësisë për punë ka qenë për një periudhë kohe të caktuar, ku gjatë kësaj periudhe Julian Lina ka qenë i mitur dhe nuk mund të realizonte të ardhura edhe sikur të ishte i aftë për punë.

12.4. *Pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar. Sipas kërkuësve, legjislacioni i zbatueshëm për përlllogaritjen e dëmit duhet të ishte ai i kohës së vdekjes (viti 2011) dhe jo ai i vitit 2007, por ky pretendim është tërësisht i pambështetur në ligj. Gjykatat kanë zbatuar drejt legjislacionin e posaçëm në fuqi në kohën kur ka ndodhur aksidenti, konkretisht rregulloren nr. 622/1, datë 15.12.1992, ku në nenin 27 të saj parashikohet se e ardhura që duhet të merret parasysh për llogaritjen e dëmshpërblimit nuk mund të jetë më e ulët se trefishi i shumës vjetore të pensionit më të ulët, sipas legjislacionit shqiptar për sigurimet shoqërore. Në rastin konkret, i ndjeri ka jetuar në fshat dhe sikurse ka referuar gjykata e apelit për përlllogaritjen e dëmit duhet të merret parasysh pensioni mesatar i përfituar në vitin 2007 dhe jo të ardhurat sipas vitit 2011. Edhe për këtë pretendim, çdo element i referuar nga kërkuësit lidhet me vlerësimin e gjykatave të faktit dhe të Gjykatës së Lartë, brenda kornizave të dhëna nga ligji material dhe procedural.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit

Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuessit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, pasi në cilësinë e trashëgimtarëve kanë qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual objekt kundërshtimi.

15. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ndaj ajo mund të kërkohe vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 29, datë 30.3.2017; nr. 39, datë 6.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vlerëson se kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të juridiksionit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për rrjedhojë ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë mban datën 26.6.2024. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues rezulton se vendimi është dërguar në adresën elektronike të avokatit të kërkuessve në datën 17.10.2024. Ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 17.2.2025, brenda afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë kërkuessit legjitimohen *ratione temporis*.

18. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuessit kanë ngritur katër pretendime (*shih paragrafin 11*). Në lidhje me pretendimin për *cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, kërkuessit kanë parashtruar se në raste të tjera analoge gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vepruar ndryshe nga rasti i tyre, megjithatë ata nuk kanë paraqitur ndonjë vendim gjyqësor konkret për të argumentuar këtë pretendim. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Për sa i takon pretendimit për *cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, kërkuessit kanë parashtruar se Gjykata e Lartë duhet ta kishte shqyrtuar rekursin e tyre në seancë gjyqësore me praninë e palëve, duke zbatuar ligjin procedural të kohës së paraqitjes së rekursit. Sipas kërkuessve, për këtë arsye atyre iu është cenuar nga Gjykata e Lartë e drejta për të marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimet lidhur me cenimin e parimit të kontradiktoritetit, disponibilitetit, së drejtës për t’u dëgjuar dhe parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit në gjykatën e apelit.

20. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se pas datës 21.4.2016, kur kërkuessit kanë ushtuar rekurs në Gjykatën e Lartë, dispozitat e KPC-së kanë pësuar ndryshime përkatësisht me ligjet nr. 38/2017 dhe nr. 44/2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Në nenin 32 të ligjit nr. 44/2021 parashikohet se përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohen sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. Rekursi e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në datën 26.6.2024 në marrjen e vendimit ka vepruar në përputhje me parimin *tempus regit processum*, duke zbatuar

legjislationin procedural në fuqi, ndaj pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

21. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, kërkuarit kanë parashtruar, ndër të tjera, argumentin se Gjykata e Lartë nuk ka pasqyruar në vendimin e saj pretendimet e ngritura në rekurs për cenimin e parimit paanshmërisë gjatë gjykimit në gjykatën e apelit. Gjykata, nga përmbajtja e dosjes gjyqësore, konstaton se kërkuarit kanë kërkuar përjashtimin e trupit gjykues, për shkak të mendimeve dhe sjelljeve të njëanshme në mbrojtje të interesave të shoqërisë së sigurimit. Për këtë kërkesë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 24.11.2015, ka vendosur rrëzimin, duke vlerësuar se pretendimet ishin të natyrës subjektive e nuk bazoheshin në asnjë provë, me anë të së cilës do të provoheshin rrethana për njëanshmëri të trupit gjykues. Po gjatë gjykimit, në gjykatën e apelit kërkuarit kanë kërkuar përjashtimin edhe të ekspertit, kërkesë që është rrëzuar gjatë seancës gjyqësore të datës 22.1.2016. Gjykata vëren se arsyetimi i vendimit të gjykatës së apelit që ka rrëzuar kërkesat e kërkuarve nuk përmban gabime të dukshme ligjore ose faktike, për rrjedhojë mospasqyrimi i pretendimit për paanshmërinë e trupit gjykues të gjykatës së apelit është i tillë që nuk vë në dyshim standardin e arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë.

22. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuarve, Gjykata konstaton se në thelb ato kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në përlllogaritjen e dëmit të shkaktuar si pasojë e humbjes së jetës së familjarëve të tyre. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se e drejta e jetës garantohet nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së. Ndërsa Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se në rast vdekjeje ose dëmtimi fizik të rrezikshëm për jetën, detyrimi pozitiv i shtetit, sipas nenit 2 të KEDNJ-së, duhet të konsiderohet se përfshin edhe krijimin e një sistemi gjyqësor efektiv dhe të pavarur, të aftë për t'i ofruar viktimës dëmshpërblim të përshtatshëm. Në rastet që kanë të bëjnë me shkaktimin e vdekjes nga pakujdesia, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse sistemi ligjor u ofron viktimave ose të afërmeve të tyre një mjet juridik në gjykimin civil, qoftë veçmas ose edhe në lidhje me një mjet juridik në gjykimin penal, duke mundësuar përcaktimin e çdo përgjegjësie dhe marrjen e çdo mjeti juridik civil të përshtatshëm (*shih Stanevi k. Bullgarisë, nr. 56352/14, datë 30.5.2023, § 51; Nicolae Virgiliu Tănase k. Rumanisë, nr. 41720/13, datë 25.6.2019, §§ 135, 157-59*).

23. Për sa më sipër, Gjykata, nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkuarve dhe bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, çmon ta analizojë çështjen nëse sistemi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm u ka ofruar kërkuarve një gjykim të drejtë, si një mjet juridik në dispozicion nga sistemi ligjor për të përfituar dëmshpërblimin e përshtatshëm nga humbja e jetës së të afërmeve të tyre.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë

24. Kërkuarit kanë pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, sepse nuk ka arsyetuar për pretendimet e ngritura në rekurs që lidheshin me zbatimin e ligjit në kohën kur ka ndodhur aksidenti dhe qëndrimin e saj që ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së apelit. Gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë kanë mbajtur qëndrim kontradiktor për vlerën e dëmshpërblimit, pasi kanë interpretuar në mënyrë të gabuar dekretin nr. 295/1992, KC-në, udhëzimin e ministrit të Financave dhe ligjin nr. 10076/2009.

25. Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimit, ka parashtruar se pretendimet e kërkuarve janë të pabazuara, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zbatuar drejt legjislationin e posaçëm në fuqi në kohën kur ka ndodhur aksidenti, konkretisht rregulloren nr. 622/1, datë 15.12.1992. Sipas subjektit të interesuar, edhe Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje çdo

pretendimi të parashtruar në rekurs dhe vendimi respekton standardin e vendosur nga jurisprudenca kushtetuese. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. E thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 25, datë 23.4.2025; nr. 67, datë 6.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata evidenton se në rastet kur pretendohet se vendimet gjyqësore përmbajnë elemente arbitrariteti, nuk vihet në dyshim e drejta e gjykatave të zakonshme për të interpretuar ligjin për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë. Por duke pasur parasysh të drejtën e individit për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, si element përbërës i së drejtës për një gjykim të drejtë, si dhe duke u kujdesur për të mos marrë trajtën e një gjykimi të zakonshëm të shkallës së katërt, për t'u dhënë përgjigje pretendimeve Gjykata kufizohet në identifikimin e gabimeve ligjore e faktike të dukshme, që shkojnë përtej pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit, që mbetet në kompetencë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 11, datë 11.2.2026, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuësve, që lidhen me interpretimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në përcaktimin e shumës së dëmshpërblimit si pasojë e humbjes së jetës së familjarëve, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata do të analizojë nëse kërkuësit kanë marrë përgjigje për kërkimin e tyre, duke shqyrtuar nëse vendimi i Gjykatës së Lartë përmban elemente arbitrariteti nga pikëpamja ligjore, të tilla që vënë në dyshim të drejtën për të pasur një gjykim të drejtë.

28. Sikurse u parashtrua në rrethanat e çështjes, kërkuësit i janë drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesëpadi duke paditur shoqërinë e sigurimit për pagimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, shpenzimet e tjera të arsyeshme e të nevojshme dhe kamatëvonesat për shkak të dëmit të shkaktuar nga aksidenti automobilistik i ndodhur në datën 9.4.2007, ku si pasojë kanë gjetur vdekjen fillimisht shtetasi Kristaq Lina e më vonë për shkak të vetëvrasjes, pasi kishte humbur plotësisht aftësinë për punë edhe shtetasi Julian Lina (*shih paragrafin 4 të vendimit*). Pasi çështja është kthyer për rigjykim nga gjykata e apelit (*shih paragrafët 6-7 të vendimit*), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë duke caktuar vlerën përkatëse të dëmshpërblimeve, e cila është ndarë fillimisht për shkak të dëmit të pësuar si pasojë e vdekjes së Kristaq Linës, duke pasur parasysh marrëdhëniet familjare me gruan Zoica Lina dhe djalalin Ilirjan Lina. Pjesa tjetër e vlerës iu është dhënë si dëmshpërblim për humbjen e jetës së Julian Linës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë për kërkimin për pagimin e kamatëvonesave. Pas ankimit të palëve ndërgjyqëse, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke detyruar shoqërinë e sigurimit të dëmshpërblejë kërkuësit për dëmin pasuror dhe jopasuror në shumën totale 12.115.957 lekë (dymbëdhjetë milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) dhe rrëzimin e padisë për kamatëvonesat (*shih paragrafin 8 të vendimit*). Kërkuësit kanë ushtruar rekurs ku, mes të tjerave, kishin parashtruar pretendime për: i. zbatimin e gabuar të ligjit specifik në fushën e sigurimeve dhe të nenit 27 të rregullores nr. 622/1, datë 15.12.1992; ii. riçeljen e hetimit gjyqësor në gjykatën e apelit, pasi

është bërë në kundërshtim me ligjin dhe nuk është zbatuar parimi i kontradiktoritetit sepse nuk është krijuar mundësia për t'i drejtuar pyetje ekspertit; iii. gjykimin në gjykatën e apelit, pasi janë rrëzuar kërkesat për përjashtimin e trupit gjykues dhe të ekspertit, ndërkohë që përjashtimi i trupit gjykues është kërkuar për arsye se nuk ka cituar në mënyrë të detajuar të gjitha shkaqet e ankimit dhe relatori është shprehur "pala paditëse besoj nuk ka pyetje për ekspertin"; iv) masën e dëmshpërblimit për Julian Linën, pasi duhet t'i shtohet edhe masa e shpërblimit për periudhën e paafësisë; v. gjykatat më të ulëta, pasi kanë gabuar në qëndrimin e tyre për kamatëvonesat.

29. Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë për kërkimin në lidhje me interesat për shumën e dëmshpërblimit, duke detyruar shoqërinë e sigurimit të paguajë interesat për vlerën totale të dëmshpërblimit të caktuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, sipas normës së interesit bazë të depozitës sipas Bankës së Shqipërisë. Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së apelit për ligjin e zbatueshëm. Gjithashtu, Gjykata e Lartë e ka gjetur të pabazuar në ligj qëndrimin e gjykatave më të ulëta për pagesën e kamatëvonesave, duke vlerësuar se e drejta për të kërkuar kamatëvonesat është në vetvete një e drejtë me natyrë ligjore dhe nuk është e kushtëzuar me momentin kohor të ngritjes së kërkesëpadisë dhe se përmbartuesi gjyqësor në momentin e ekzekutimit duhet të llogarisë kamatëvonesat në bazë të përqindjes së normës bazë të interesit të miratuar nga Banka e Shqipërisë (*shih paragrafin 9 të vendimit*).

30. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka interpretuar ligjin e zbatueshëm në koherencë me rrethanat e çështjes, mbi bazën e të cilave ka arritur në mënyrën e zgjidhjes së çështjes, duke përcaktuar ligjin e zbatueshëm për përcaktimin e vlerës së dëmshpërblimit dhe duke i dhënë të drejtë kërkuarve edhe për kërkimin e kamatëvonesave, pavarësisht se ky kërkim nuk ishte bërë në momentin fillestar të paraqitjes së kërkesëpadisë, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga gjykatat më të ulëta. Gjykata konstaton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në respektim edhe të *parimit të subsidiaritetit*, ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së apelit lidhur me metodologjinë e përcaktimit të shpërblimit të dëmit pasuror dhe jopasuror, duke iu referuar dekretit nr. 295/1992, rregullores të dalë për zbatimin e tij për përcaktimin e dëmit pasuror, si dhe vendimit unifikues nr. 12/2007 për rregullimin e dëmit jopasuror, për shkak se për rregullimin e tij nuk ka asnjë parashikim si në dekret dhe rregullore. Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkuarët për ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e rastit konkret, për riçeljen e hetimit gjyqësor nga gjykata e apelit, gjë që ka ndodhur në zbatim të nenit 465 të KPC-së dhe se ata kanë pasur mundësi t'i drejtojnë pyetje ekspertit, duke mos evidentuar shkelje procedurale. Ata kanë realizuar edhe të drejtën e tyre për kërkimin e shumave të shpërblimit dhe të kamatëvonesave, për shkak të humbjes së jetës së familjarëve të tyre. Gjithashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur edhe kriteret që do të mbahen parasysh në llogaritjen e interesave, që do të jetë norma e interesit bazë të depozitës (sipas llojit të saj), bazuar në përcaktimet e Bankës së Shqipërisë. Në këto optikë, Gjykata vlerëson se pjesa arsyetuese e vendimit të Gjykatës së Lartë ka respektuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, duke garantuar në këtë mënyrë edhe thelbin e *së drejtës së jetës*, të parashikuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së, në kuptim të garantimit të së drejtës për dëmshpërblim të përshtatshëm për familjarët e viktimës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se interpretimi i ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Lartë nuk është haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar, duke mos u evidentuar gabime të dukshme ligjore.

31. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarve për cenimin e *së drejtës për gjykim të drejtë* është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.1.2026.

Shpallur më 19.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Sandër Beci,
Asim Vokshi